



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.09.2022

MBLEDHJA Nr. 42,
Datë 29.09.2022, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 29.09.2022, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 42 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 22.09.2022 dhe datë 23.09.2022
2. Mbi kërkesën e OST sh.a., për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2, të vendimit të ERE nr.78, datë 13.04.2022, “Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020”
3. Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW, me kapacitet total të instaluar 48 864 kW
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 480, seria T21, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 25.01.2021
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të

dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI